



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS

Nr. 6095 prot.

Tiranë, më 28/9 /2023

MEMO

LËNDA: Mbi publikimin e njoftimit të Programit YES

Drejtuar: Znj. Ogerta Manastirliu, Ministër

Konfirmoi: Z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm

Znj. Zamira Gjini, Drejtor i Përgjithshëm

Miratoi: Znj. Eglantina Killo, Drejtor

Z. Shkëlqim Allkaj, Drejtor

Pranoi: Znj. Dorisjana Hasani, Përgjegjëse sektori

Konceptoi: Z. Gerald Jaupi, Specialist

E nderuar znj. Ministre,

Zyra e Këshillave Amerikane për Arsimin Ndërkombëtar, e cila administron programin YES, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike kërkesën për mundësinë e informimit të nxënësve të klasave të dhjeta dhe të njëmbëdhjeta të sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë për programin YES. Ky program është i vlefshëm për rritjen profesionale të të rinjve shqiptarë dhe për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë shqiptare.

Programi YES është një program shkëmbimi i themeluar në vitin 2002 nga Kongresi Amerikan dhe financohet plotësisht nga qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Programi filloi zyrtarisht në Shqipëri në vitin 2009 me shpresën për të zgjeruar komunikimin midis popullit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë në mënyrë që të promovojë mirëkuptimin dhe respektin reciprok. Që atëherë, 170 nxënës shqiptarë kanë përfunduar programin YES dhe tani marrin pjesë si alumni.

Ky program iu siguron nxënësve të shkollave të mesme, të përzgjedhur përmes konkursit të administruar nga Zyra e Këshillave Amerikane për Arsimin Ndërkombëtar, të jetojnë një vit shkollor në SHBA në një familje mikpritëse vullnetare amerikane. Ata kanë mundësinë e studimit në një shkollë të mesme në SHBA, për të nxitur të kuptuarit mes njerëzve në SHBA dhe popujve të tjerë në botë.

Zyra e Këshillave Amerikane për Arsimin Ndërkombëtar dërgon çdo vit kërkesën në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për mundësinë e informimit të nxënësve të klasave të dhjeta dhe të njëmbëdhjeta të sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë për programin YES. Praktika ndër vite ka konsistuar në publikimin e kësaj thirrje në faqen zyrtare web të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në seksionin “Bursa dhe Programe Studimi”, si dhe përcjellja e njoftimit me email në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

Lutemi, gjeni bashkëlidhur njoftimin për publikim.

Duke ju falenderuar,



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË PROGRAMIN YES

YES (Kennedy Lugar-Youth Exchange and Study) është një program pa pagesë që ofron bursa studimi për nxënësit e shkollave të mesme nga Shqipëria për të studiuar një vit shkollor (2024-2025) në një shkollë të mesme amerikane, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke jetuar me familje amerikane.

Fokusi i programit është zhvillimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendeve partnere, me qëllim rritjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Nxënësit jetojnë në një familje pritëse amerikane, ndjekin shkollën e mesme, angazhohen në aktivitete për të mësuar mbi shoqërinë dhe vlerat amerikane.

Ky program mbështetet financiarisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Këtë vit, fazat e para të testimit do të jenë online nga data 1 gusht 2023 deri 24 tetor 2023. Duhet të regjistroheni në faqen: <http://ais.americancouncils.org/yes>, ku duhet të plotësoni fillimisht një aplikim të përbërë prej disa pyetjeve biografike dhe 3 eseve të shkurtra.

Kriteret për të aplikuar:

- të keni lindur në periudhën nga 1 janar 2007 - 15 korrik 2009 dhe të jeni nxënës në shkollë të mesme në Shqipëri, në klasën e 10-të ose të 11-të - të jeni nxënës me rezultate të mira;
- të keni njohuri të mira të gjuhës angleze;
- të jeni shtetas shqiptar;
- Nxënësit me aftësi të kufizuar duhet të jenë të lindur nga 15 shkurt 2006- 15 korrik 2009 dhe të jenë në cilëndo klasë.

Për çdo pyetje mund të kontaktoni në adresën elektronike: yes.al@americancouncils.org

SUKSESE!